

INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK TIRANE
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

[Data:26.07.2019]

Për: **“NRG” sh.p.k.**
Adresa: Rruga “Eduart Mano”, pallatet nr. 10, Kopshti Zoologjik, Selitë, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: ***Procedurë e Hapur - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.***

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-11174-02-28-2019**
Numri i referencës së LOTIT të II-të: **REF-11181-02-28-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”***

- **LOTI II: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”,** me fond limit të planifikuar për 2 vjet në vlerë 43,593,744 (dyzetë e tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSh; Shumatorja e çmimeve njësi të shërbimeve të parashikuara për këtë lot është 56,208 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSh;

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme **X çmimi më i ulët**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

LOTI II: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria "AIR" sh.p.k., me NIPT: L51712008C dhe Shoqëria "TRULY NOLEN" sh.p.k., me NIPT: L91519037C, të përfaqësuar nga Shoqëria "AIR" sh.p.k., me shumatore të çmimeve në vlerën 34.149 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSh;
2. Shoqëria "AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK" sh.p.k., me NIPT: L32402038K, me shumatore të çmimeve në vlerën 43.000 (dyzet e tre mijë) lekë pa TVSH;
3. Personi fizik "FATOS LASHI", me NIPT: K91315005H, me shumatore të çmimeve në vlerën 47.406 (dyzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtë) lekë pa TVSH;
4. Shoqëria "NRG" sh.p.k., me NIPT: L13426006B dhe me shumatore të çmimeve në vlerën 50.410 (pesëdhjetë mijë e katërqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria "AIR" sh.p.k., me NIPT: L51712008C dhe Shoqëria "TRULY NOLEN" sh.p.k., me NIPT: L91519037C, të përfaqësuar nga Shoqëria "AIR" sh.p.k.;
2. Shoqëria "AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK" sh.p.k., me NIPT: L32402038K;
3. Personi fizik "FATOS LASHI", me NIPT: K91315005H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

BOE "AIR" sh.p.k., dhe "TRULY NOLEN" sh.p.k. është SKUALIFIKUAR për arsye se ky ofertues nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Formulari i ofertës është paraqitur sipas shtojcës 1, është përcaktuar % e pjesëmarrjes së shërbimit (25% dhe 25%, si më sipër) në kontratën e bashkepunimit të përkohshëm me nr. 829 rep dhe nr. 148/1 kol., që në total mbulojnë 50% të shërbimit që do të kryhet, ndërsa 50% mbetet e pambuluar. Gjithashtu BOE nuk ka përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga anetarët e tij, kjo në kundërshtim me pikën 2, të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar;
2. Vërtetimi i paraqitur nga Shoqëria "AIR" sh.p.k., për përmbushjen e kriterit për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit nuk përmbush vlerën sipas përqindjes që zotëron në marrëveshjen e bashkëpunimit;
3. Deklarata e paraqitur nga të dy Operatorët Ekonomikë të BOE, për përmbushjen e kriterit që duhet të kenë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e paisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren, nuk përmban personin/at përgjegjës që do të kryejë/në kalibrimin e paisjeve;

Shoqëria "AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK" sh.p.k. është SKUALIFIKUAR bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 334/2019, date 03.06.2019, për arsye të mospërmbushjes së kriterit nr 2, kapaciteti teknik, të Dokumenteve Standarde të Tenderit për Lotin e II-të, se *"OE duhet të disponojë makineritë dhe paisjet e mëposhtme: a) Aparat mjegullues për mjegull të ftohtë dhe Pompë me presion të lartë të montuar në një kamionçinë për lotet si më poshtë: Të paktën 2 (dy) Aparat mjegullues me pompë me presion, të montuar në një kamionçinë për Lotin 2"*.

SUBJEKTI "FATOS LASHI" është SKUALIFIKUAR bazuar në Shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 3159 prot., datë 11.06.2019 *"Anullim i Autorizimit të Importit për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G"*, për arsye të mospërmbushjes së kriterit 3, kapaciteti teknik, të Dokumenteve Standarde të Tenderit për Lotin e II-të, se *"Në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike, OE duhet të paraqesë etiketat dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet e përcaktuar sipas loteve. Formulimet dhe përqëndrimet e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:*

- a. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis (Bti)* mikrogranula të tretshme në ujë (**WG**) me fuqi 3000 I.T.U./mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare).
- b. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis (Bti)* granular (**G**) me fuqi 200 I.T.U për mg.
- c. Film monomolekular është një produkt me bazë silikon, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqendrimin 1ml/m²."

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. Shoqëria "NRG" sh.p.k.

NIPT: L13426006B

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është në vlerën 50.410 (pesëdhjetë mijë e katërqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Institutit të Shëndetit Publik, me adresë Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.06.2019

Ankesa: PO

Nga OE "FATOS LASHI"

Ka marrë përgjigje në datë 25.06.2019